



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic
of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Raport i Punës

SË MINISTRISË SË ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL

Janar – Dhjetor 2015

Ky raport paraqet punën e MAPL-së për nëntëmuajorin e vitit 2015.

Raporti përmbledhë aktivitetet e të gjitha njësive organizative të MAPL-së duke u koncentruar në pesë fusha kryesore, të cilat përbëjnë objektivat e punës së ministrisë.

Përmbajtja

Shkurtesat.....	4
Përmbledhje ekzekutive.....	5
1. Zhvillimi dhe Zbatimi i Legjislacionit.....	7
2. Zhvillimi i politikave nga fusha e vetëqeverisjes lokale	7
4. Koordinimi institucional dhe promovimi ndërkombëtar i vetëqeverisjes lokale	10
5. Agjenda evropiane.....	12
6. Ngritja e kapaciteteve institucionale të komunave.....	12
7. Performanca Komunale	16
8. Promovimi i të drejtave të njeriut në Komuna	16
9. Promovimi i transparencës.....	19
10. Administrata dhe Financat	20

Shkurtesat

AKP	Agjensioni Kosovar i Privatizimit
AZHR	Agjensionet për Zhvillim Rajonal
BNK	Bashkëpunimi Ndërkufitar
DEMOS	Decentralizimi dhe Mbështetja e Komunave
DIEKP	Departamenti për Integritime Evropiane dhe Koordinim të Politikave
DIE	Divizioni për Integritime Evropiane
DKP	Divizioni për Koordinim të Politikave
GIZ	Bashkëpunimi Gjerman për Zhvillim
IE	Integritet Evropiane
IKAP	Instituti Kosovar për Administratë Publike
IPA	Integrimi para anëtarësimit
KEVL	Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale
LVL	Ligji për Vetëqeverisje Lokale
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MF	Ministria e Financave
OJQ	Organizata Jo qeveritare
OSCE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian
PVNMSA	Plani i Veprimit për Negocimin e Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit
RAE	Komuniteti rom, ashkali dhe egjiptas
SVL	Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016 – 2026
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
USAID	Agjensioni për Zhvillim Ndërkombëtar
ZKM	Zyra e Kryeministrit

Përmbledhje ekzekutive

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) në përputhje me mandatin e saj dhe objektivat e Deklaratës Prioritare të Politikave Afatmesme 2014 - 2016, është përqendruar në përmbushjen e Planit të Punës për periudhën Janar-Dhjetor 2015. Raporti pasqyron veprimet dhe rezultatet e arritura sipas fushave të planifikuara:

- Zhvillimi dhe Zbatimi i Legjislacionit;
- Zhvillimi i politikave nga fusha e vetëqeverisjes lokale;
- Agjenda evropiane;
- Ngritja e kapaciteteve institucionale të komunave;
- Performanca Komunale;
- Promovimi i të drejtave të njeriut në Komuna;
- Promovimi i transparencës;
- Administrata dhe Financat.

Nga fusha e zhvillimit dhe e zbatimit të legjislacionit, MAPL ka finalizuar Koncept-Dokumentin për Projektligjin e Kryeqytetit të Republikës së Kosovës i cili është miratuar nga Qeveria. Po ashtu është dërguar për aprovim në Qeveri, Projekt-Rregullorja për shqyrtimin administrativ të akteve të komunës, është finalizuar dhe nënshkruar Udhëzimi Administrativ 01/2015 për transparencë në komuna, si dhe Udhëzimi Administrativ 02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit të komunës. Janë shqyrtuar dhe dërguar në komuna 19 kërkesa për rishqyrtim të ligjshmërisë, si dhe janë shqyrtuar 29 ankesa të adresuara kundër vendimeve të ekzekutivit të komunave. Gjatë kësaj periudhe janë monitoruar 449 mbledhje të kuvendeve të komunave, prej të cilave 404 mbledhje të rregullta dhe 45 të jashtëzakonshme. Nga 1762 akte të miratuara nga kuvendet e komunave, MAPL ka vlerësuar 1036 akte, prej të cilave 726 janë dërguar për shqyrtim në Ministrinë e linjës.

Në lidhje me avancimin e reformës së pushtetit lokal dhe koordinimin e politikave, bazuar në Planin Vjetor të Dokumenteve Strategjike për vitin 2015, është finalizuar Strategjia për Vetëqeverisjen Lokale 2016-2026 dhe Plani i Veprimit, e cila është miratuar nga Qeveria. MAPL ka koordinuar aktivitetet me njësitë e brendshme të saj si, ministrive të linjës dhe komunave sa i përket vlerësimit të ligjshmërisë së akteve komunale dhe obligimeve të tjera që dalin nga raportet ndërinsticionale si dhe obligimeve nga agjenda evropiane. Është hartuar plani i punës së MAPL-së për Qeveri për vitin 2016, si dhe Plani i hollësishëm i punës së MAPL-së për vitin 2016.

Gjatë periudhës një vjeçare është dhënë kontributi në ofrimin e propozimeve për Strategjinë Kombëtare për Zhvillim, Strategjinë për decentralizim fiskal, Strategjinë për

trashëgimi kulturore, si dhe është përgatitur kapitulli për zhvillimin lokal për nevoja të dokumentit sektorial “Konkurrueshmëria”.

Me qëllim të forcimit të kapaciteteve institucionale dhe infrastrukturore të komunave, janë lidhur 76 Marrëveshje të Mirëkuptimit në vlerë prej 3,187,445,00 € në mes MAPL dhe Komunave për implementimin e 76 projekteve. Në periudhën raportuese kanë përfunduar 65 projekte. Kurse nga infrastruktura komunale të financuara nga BE për fazën e VII kanë përfunduar 9 nga 20 projekte, është nënshkruar kontrata për finalizimin e 4 objekteve komunale në komunat Obiliq, Fushe Kosove, Podujeve dhe Vushtrri.

Në fushën e ngritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore, MAPL ka përgatitur raportin për vlerësimin e kapaciteteve në komuna për vitin 2015 dhe Planin e trajnimeve për vitin 2016. MAPL ka ofruar mbështetjen për trajnimin e 1621 zyrtarëve të komunave në bashkëpunim me partnerët që kanë sponsoruar organizimin e trajnimeve. MAPL ka hartuar programin e trajnimeve në fushën e integriteteve evropiane për zyrtarët komunal për integritete evropiane, zyrtarët e tjerë komunal dhe zyrtarët e MAPL-së.

Në Programet e Bashkëpunimit Ndërkufitar Kosovë – Shqipëri dhe Kosovë-Maqedoni ka vazhduar implementimi dhe monitorimi projekteve të përbashkëta me këto shtete. Kurse, në Programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar Kosovë – Mali i Zi, është përmbyllur vlerësimi i thirrjes për propozime dhe janë nënshkruar 9 kontrata për 9 projekte të përbashkëta në vlerë rreth 1.6 mil € vetëm nga Alokimet e destinuar për Kosovë.

MAPL në vazhdimësi u ka ofruar përkrahje të rëndësishme komunave në përmbushjen e detyrimeve që dalin nga procesi i integriteteve evropiane. Në komuna janë adresuar të gjitha obligimet që dalin nga agjenda evropiane. Janë hartuar raportet periodike nga Plani i Veprimtari Komunal për MSA-në 2015, si dhe janë identifikuar sfidat nga Raporti i Vendi 2015 për MAPL-në dhe Komunat. Po ashtu janë ofruar informata dhe të dhëna për punën e MAPL-së dhe Komunave për sa i përket raportimit për Inputin e II-të të Raportit të Komisionit Evropian për vendin-Kosovë për periudhën 1 maj 2015–31 gusht 2015. Në kuadër të Dialogut të Procesit të Stabilizimit Asociimit, MAPL ka raportuar për këto nën-komitete: Drejtësi, Liri dhe siguri; Inovacion dhe trashëgimi kulturore; Transport, Mjedis, Energji dhe Zhvillim Rajonal. Është ofruar mbështetja në finalizimin e Planit Kombëtar për Adoptim të Acquis së BE-së, në hartimin e Programit Kombëtar për zbatimin e MSA-së, si dhe finalizimin e Dokumentit Planifikues Konkurrueshmëria, prej të cilit dokument është përgatitur Action Document “Improvement of business services and infrastructure in municipalities”.

MAPL është fokusuar edhe në fushën e zhvillimit të kapaciteteve dhe performancës komunale. Në këtë aspekt, janë rishikuar indikatorët matës të performancës komunale dhe është hartuar raporti Raporti gjashtëmujorë i performancës së komunave të Republikës së Kosovës. Është bërë analiza e funksionimit të Sistemit për Menaxhim të Performancës së Komunave, është bërë vlerësimi i tregueseve të SMP dhe është vlerësuar nevoja për rishikimin e tregueseve të SMP-së.

Gjithashtu, janë hartuar dokumentet si vijon: 1) Raporti krahasues për kërkesat për qasje në dokumente publike në komuna për periudhën janar-qershor 2015; 2) Drafti fillestar i indikatorëve për transparencë në komuna; 3) Raporti për promovimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut në nivel lokal.

1. Zhvillimi dhe Zbatimi i Legjislacionit

Gjatë periudhës tetor-dhjetor, me Vendimin Nr. 7/58 të Qeverisë së Republikës së Kosovës është miratuar Koncept-Dokumenti për Projektligjin e Kryeqytetit të Republikës së Kosovës. MAPL ka dërguar për aprovim në Qeveri Projekt-Rregulloren për shqyrtimin administrativ të akteve të komunës. Është finalizuar dhe nënshkruar Udhëzimi Administrativ 01/2015 për transparencë në komuna si dhe Udhëzimi Administrativ 02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit të komunës. Ndërsa, duke u bazuar në Programin Legjislativ dhe me qëllim të harmonizimit të akteve sektoriale me legjislacionin për vetëqeverisje lokale janë dhënë deklaratat e harmonizimit për 43 akte ligjore dhe nënligjore.

Është pranuar 1 kërkesë për konsultim paraprak lidhur me propozim projektet e propozuara që prekin fushën e planifikimit hapësinor. Janë shqyrtuar 29 ankesa kundër vendimeve të ekzekutivit, për të cilën pretendohet se janë shkelur interesat e palëve. Janë pranuar dhe shqyrtuar 11 këshilla ligjore, natyra e të cilave ka të bëjë me interpretimin e dispozitave ligjore të Ligjit për vetëqeverisje lokale dhe Ligjit për Shpronësim. Po ashtu janë dërguar shkresat përcjellëse në komuna, lidhur me identifikimin e obligimeve ligjore që dalin nga Ligji Nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendor. Lidhur me këtë është përgatitur mekanizmi i ligjeve lidhur me përgjegjësit që kanë komunat nga ligjet e miratuara në vitin 2015. Po ashtu gjatë kësaj periudhe është përgatitur analiza lidhur me identifikimin e vështirësive që kanë pasur komunat në zbatim të legjislacionit në fuqi për vitin 2015.

MAPL ka vazhduar monitorimin e komunave sipas mandatit ligjor. Gjatë kësaj periudhe janë monitoruar 449 mbledhje të kuvendeve të komunave, prej të cilave 404 mbledhje të

rregullta dhe 45 të jashtëzakonshme. Nga 1762 akte të miratuara nga kuvendet e komunave, MAPL ka vlerësuar 1036 akte, prej të cilave 726 janë dërguar për shqyrtim në Ministrinë e linjës.

Edhe gjatë kësaj periudhe kemi pasur raste kur komunat nuk kanë vepruar në harmoni me legjislacionin në fuqi në komunat e Republikës së Kosovës. Janë evidentuar 33 shkelje ligjore, për të cilat MAPL ka dërguar kërkesat për rishqyrtim dhe harmonizim të këtyre akteve me legjislacionin në fuqi. Në këtë periudhë Kuvendet e komunave të Republikës së Kosovës i kanë rishqyrtar 25 shkelje të cilat janë harmonizuar në harmoni me rekomandimet e MAPL-së, ndërsa, 7 shkelje ligjore mbetet të rishqyrtohen brenda afateve ligjore.

Gjatë kësaj periudhe MAPL në mënyrë të veçantë ka monitoruar dhe ofruar mbështetjen për komunat: Zubin Potok, Zvečan, Leposaviq dhe Mitrovicë e Veriut. MAPL ka përgatitur Listën e Akteve komunale dhe planeve që obligohen të miratojnë kuvendet e këtyre komunave. Për të ofruar mbështetjen në ndërtimin e kapaciteteve të këtyre komunave, MAPL në bashkëpunim me ZKM dhe në përkrahje të USAIDIT, ka zhvilluar takime me këto komuna lidhur me publikimin e akteve komunale në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

MAPL ka hartuar monitorin e akteve të komunave për këtë periudhë raportuese në të cilën janë listuar të gjitha akteve të komunave të miratuara gjatë kësaj periudhe. Me qëllim të përkrahjes së komunave për zbatimin më të mirë të obligimeve ligjore Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka bërë publikimin e udhëzuesit për zëvendës kryesuesit e kuvendit të komunës për komunitete.

Po ashtu gjatë kësaj periudhe është mbajtur takimi me kryesues të Kuvendeve të Komunave ku është bërë prezantimi i rekomandimeve të dala nga raporti i monitorimit gjithëpërfshirës të komunave lidhur me zbatimin e përgjegjësive, hartimin e akteve që burojnë nga ligjet sektoriale si dhe harmonizimin e kërkesave për rishqyrtimin e ligjshmërisë së tyre. Në këtë periudhë është bërë publikimi i raportit të tremujorit të tretë për monitorim dhe funksionim të komunave, monitori i tre mujorit të tretë për miratim të akteve komunale si dhe mirëmbajtja e listës së shkeljeve ligjore. Po ashtu janë vizituar të gjitha komunat e Republikës së Kosovës lidhur me publikimin e akteve komunale në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Është finalizuar edhe raporti për Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi për këtë periudhë.

2. Zhvillimi i politikave nga fusha e vetëqeverisjes lokale

Me qëllim të avancimit të politikave strategjike për zhvillimin e vetëqeverisjes lokale, MAPL, në bazë të Planit Vjetor të Dokumenteve Strategjike për vitin 2015, ka finalizuar Strategjinë për Vetëqeverisjen Lokale 2016-2026. Pas konsultimeve që janë bërë me të

gjithë akterët e përfshirë, marrjen e komenteve dhe finalizimin e saj, Strategjia është miratuar në Qeveri dhe Plani i Veprimtimit 2016-2026. Në kuadër të avancimit të fushës së qeverisjes lokale dhe bashkëpunimit më të mirë me akterët tjerë, janë dhënë komente në dokumentin qeveritar *"Konkurueshmëria"*. Po ashtu gjatë kësaj periudhe është bërë shqyrtimi i draftit të azhurnuar të Strategjisë kombëtare për zhvillim. Pastaj, është hulumtimit i informatave të ndryshme për mbledhjen e të dhënave në mënyrë që të fillohet hartimi i Profilit të Komunave të Republikës së Kosovës. Po ashtu janë analizuar informata në lidhje me analizën për Trashëgimin Kulturore dhe Natyrore në komunat e Republikës së Kosovës për nevoja të MAPL, ka përfunduar analizën e implementimit të planit të punës për periudhën Janar-Dhjetor 2015.

Janë hartuar raportet si vijon: raporti i punës së MAPL-së për K2 dhe K3 2015, raporti i punës së MAPL-së për Qeveri dhe raporti i punës së MAPL-së për zbatimin e vendimeve të Qeverisë (K2 dhe K3 - 2015), të cilat janë proceduar pastaj në sistemin online të qeverisë në afatet e parapara. Sa i përket zhvillimit të dokumenteve gjatë kësaj periudhe, është finalizuar dokumenti për promovimin e Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, Draft-Udhëzuesi për menaxhimin e pronës së paluajtshme komunale, si dhe modelet e profileve të Komunave të Republikës së Kosovës".

MAPL ka monitoruar dhe mbështetur komunat në hartimin e planeve të integruara komunale me qëllim të adresimit të obligimeve të komunave në këtë fushë. Është bërë organizimi i këshillimit me DEMOS-it lidhur me temën, "Ofrimi i asistencës teknike", kjo me qëllim të nxitjen për ngritje kualitative të raporteve. Përgatitja e "Model Udhëzuesit" mbi procedurat që duhet ndjekur para se të arrihet ndonjë Marrëveshje Bashkëpunimi ndërkomunal ose komunal ndërkombëtar. Organizimi i punëtorisë nga: USAID-MAPL, Programi: Të avancojmë Kosovën së bashku - zgjidhje vendore, i cili financohet nga USAID dhe implementohet nga CDF lidhur me temën: *"Ngritja e fondeve për komuna dhe shërbime komunale"*.

MAPL si anëtare e grupit punues për decentralizim fiskal ka përgatitur propozimet për dokumentin *"Strategjia për Financa të Pushtetit Lokal"*, pastaj me qëllim të dhënies së kontributit të vet MAPL ka qenë aktive në grupet punuese për Strategjinë Kombëtare për Zhvillim,. Është finalizuar Model-Strategjia dhe Model-Plani për Zhvillim Socio-Ekonomik dhe është dërguar në komuna. Gjithashtu, është mbajtur seminari me komuna për t'i përkrahur komunat për hartimin e strategjive lokale.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2015 janë mbajtur 6 takime të grupit të përbashkët punues MF-MAPL për vlerësim të ligjshmërisë së rregulloreve komunale për tarifa ngarkesa dhe gjoba. Me qëllim të raportimit periodik është përgatitur raporti lidhur me lëvizjet e stafit në komunat: Mitrovica Veriore, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok dhe është

bërë krahasimi me periudhën paraprake raportuese, si dhe është bërë analiza e buxheteve të këtyre komunave për vitin 2016 dhe krahasimi i tyre me vitin 2015. Është hartuar raporti gjashtëmujor për realizimin e të hyrave vetanake komunale.

Lidhur me investimet kapitale në komuna në këtë periudhë është hartuar raporti i investimeve kapitale në komuna në sektorin e ujërave për periudhën 2015-2017. Është finalizuar analiza e të hyrave vetanake të komunave për periudhën 2010-2014 dhe është mbajtur seminari me komuna për prezantimin e të gjeturave dhe rekomandimeve.

Eshtë finalizuar analiza e shpenzimeve për periudhën 2010-14, si dhe është përgatitur raporti i gjendjes aktuale të buxhetit të komunave për komunitetet pakicë.

Rol të rëndësishëm ka pasur edhe organizimi, aranzhimi dhe mbajtja e takimeve në pesë rajonet ekonomike (Qendër, Veri, Jug, Lindje dhe Perëndim) me të gjitha komunat lidhur me hartimin e planeve të integruara të komunave 2016-2018, dhe deri me tani 10 komuna i kanë hartuar planet e integruara për periudhën 2016-2018.

3. Koordinimi institucional dhe promovimi ndërkombëtar i vetëqeverisjes lokale

Gjatë kësaj periudhe është hartuar Plani i Punës së MAPL-së për vitin 2016 i dërguar në Qeveri. Janë koordinuar aktivitetet me departamentet e tjera dhe njësisive organizative në hartimin e dokumenteve strategjike, planeve dhe dokumenteve të tjera relevante. Janë identifikuar të gjitha obligimet që dalin nga Plani i Veprimit të Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale për vitin 2016.

Avancimi i formave të ndryshme të bashkëpunimit të komunave ka qenë një ndër prioritetet e MAPL-së gjatë kësaj periudhe. Sa përket promovimit ndërkombëtar të vetëqeverisjes lokale në fokus të veçantë ka qenë Bashkëpunimi Ndërkufitar me tri vendet fqinje: Shqipërinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë përmes tri Programeve të Bashkëpunimit Ndërkufitar të financuara nga Bashkimi Evropian:

Në Programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar Kosovë – Shqipëri, ka vazhduar implementimi dhe monitorimi i 6 projekteve të përbashkëta si pjesë e dy Masave prioritare të këtij Programi: 1. Promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, social dhe mjedisor dhe 2. Kohezioni social dhe shkëmbimi kulturor përmes veprimeve mes njerëzve dhe institucioneve. Është hapur tenderi nga Zyra e BE-së për dizajnimin dhe mbikëqyrjen e Projektit strategjik, është bërë vlerësimi i ofertave të kompanive dhe është përzgjedhur kompania fituese e cila do të bëjë dizajnimin e projektit dhe mbikëqyrjen e punëve gjatë

realizimit e cila ka filluar me pergaditjen e dizajnit te projektit. Projekti strategjik përfshin ndërtimin e parkingut në pikën kufitare dhe rrugës së gjatë rreth 3.2 km që lidhë Dragashin me pikën kufitare ne Shishtavec/Shqipëri. Është ratifikuar marrëveshja Financiare tri paleshe mes Kosovës, Shqipërisë dhe Zyrës së Komisionit Evropian në Shqipëri për alokimin e mjeteve financiare nga viti 2014 për Programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar Kosovë – Shqipëri, IPA II, 2014 – 2020. Gjithashtu është nënshkruar Service Contract për implementimin e programit 2014-20 për alokimet financiare 2014-2016.

Në Programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar Kosovë – Mali i Zi, gjatë kësaj periudhe është përmbyllur vlerësimi i Thirrjes për Projekt Propozime si dhe janë nënshkruar 9 kontrata me datë 30 Gusht 2015. Në dispozicion të përfituesve potencial nga Kosova janë 1,620,000 € dhe 1,620,000 € për Malin e Zi (në total 3,240,000 €). Projektet përfituese nga kjo thirrje janë në përputhje me tri Masat prioritare të këtij Programi: 1. Mbrojta e Ambientit, 2. Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe 3. Kohezioni social dhe iniciativat e përbashkëta mes njerëzve. Është finalizuar marrëveshja Bilaterale me Malin e Zi lidhur me implementimin e Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Kosovë – Mali i Zi, IPA II, 2014-2020 dhe është dërguar për aprovim në Komisionin Evropian, gjithashtu është nënshkruar Service Contract për implementimin e programit 2014-20 për alokimet financiare 2014-2016.

Në Programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar Kosovë – Maqedoni, ka vazhduar implementimi dhe monitorimi i 6 projekteve të përbashkëta si pjesë e dy Masave prioritare të këtij Programi: 1. Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, social dhe mjedisor dhe 2. Kohezioni social dhe iniciativat e përbashkëta mes njerëzve. Kanë vazhduar konsultimet me të gjithë aktorë e përfshirë nga institucionet e Kosovës, institucionet e Maqedonisë dhe përfaqësuesit e Komisionit Evropian në dy shtetet lidhur me realizimin e projektit strategjik për ndërtimin e objektit dhe hapjen e pikës kufitare ne Stanqiq (Kosovë) – Belanovcë (Maqedoni). Gjithashtu është nënshkruar Service Contract për implementimin e programit 2014-2020 për alokimet financiare 2014-16.

Krahas takimeve bilaterale me shtetet e tjera, me qëllim të koordinimit të aktiviteteve, sipas një agjende të rregullt janë mbajtur takimet me strukturat lokale si vijon: Zyrtarët e integriteteve evropiane, drejtorët e administratës dhe koordinatorët e të drejtave të njeriut.

Po ashtu është bërë koordinimi me departamentet e MAPL-së për plotësimin e të dhënave për Raportin e vendit për Komisionin Evropian. Është bërë koordinimi i aktiviteteve me departamentet tjera brenda MAPL-së për finalizimin e propozimeve për Strategjinë kombëtare për zhvillim. Janë dhënë përgjigje për Studimin e iniciuar nga Zyra e Bashkëpunimit Zviceran në Kosovë (SDC) e cila është pjesë e programit të

DEMOS, për studimin e fizibilitetit për zhvillimin e sistemit për ngritjen e kapaciteteve për qeverisjen lokale në Kosovë. Është bërë përgatitja e raportit për identifikimin e veprimeve që kufizojnë konkurrencën e lirë, përmes vendosjes ose abuzimit të pozitës dominuese ose praktikave që e kufizojnë konkurrencën, që krijojnë obligime për qytetarët.

Rëndësi ka pasur edhe pjesëmarrja në grupin ndërministror MAPL-MMPH për shqyrtimin e ligjshmërisë së akteve në fushën e mjedisit. Është dhënë kontributi në kuadër të takimeve të grupit punues për rishikimin e dokumenteve strategjike, ligjore dhe nënligjore, me qëllim të evidentimit të barrierave eventuale që kufizojnë konkurrencën e lirë, si dhe caktimin e detyrimeve për qytetarët, të cilat nuk janë paraparë me ligj. Krahas kësaj, janë dhënë komentet dhe propozimet për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim. Janë organizuar takime me komunat dhe AZHR-të për planet e integruara komunale dhe është bërë prezantimi për profilin e komunave. MAPL ka qenë pjesëmarrëse në takimin informues të Këshillit të Ministrave për Strategjinë për “Modernizimin e Administratës Publike, pastaj në takimin e organizuar nga DLMK për U.A. për PZHK-të dhe U.A. për Hartat zonale të komunave. Në bashkëpunim me OSBE-në është organizuar takim një ditor me përfaqësuesit e skomunave për draftimin e Rregullores për shqyrtimin administrativ të akteve komunale.

4. Agjenda evropiane

Duke marrë parasysh se MAPL koordinon procesin e integritimeve evropiane me komunat, në raport me MIE dhe Komisionin Evropian, gjatë kësaj periudhe në komuna janë adresuar të gjitha obligimet që dalin nga agjenda evropiane. Sipas planit të vizitave, janë mbajtur takimet e përbashkëta me kryetarët e komunave dhe drejtorët e drejtorive. Paraprakisht janë hartuar 38 plane të integruara komunale, me qëllim të adresimit të obligimeve të komunave nga procesi i stabilizim asociimit, dialogu i liberalizimit të vizave si dhe adresimi i sfidave nga raportet e progresit. Në këtë drejtim, është hartuar edhe “ Raporti për realizimin e vizitave në komunat e Republikës së Kosovës për sa i përket përmbushjes së obligimeve që dalin nga agjenda evropiane”.

Në kuadër të Dialogut të Procesit të Stabilizim Asociimit, MAPL ka raportuar për këto nën-komitete:

- Drejtësi, Liri dhe siguri;
- Inovacion dhe trashëgimi kulturore;
- Transport, Mjedis, Energji dhe Zhvillim Rajonal;

MAPL gjatë kësaj periudhe ka hartuar edhe “ Raportin për Planin e Veprimit Komunal për MSA-në për periudhën janar – mars 2015”, “Raportin për Planin e Veprimit Komunal për MSA-në për periudhën janar-qershor 2015”, “ Raportin për Planin e Veprimit Komunal për MSA-në për periudhën janar – shtator 2015”, si dhe “Draftin e Raportit për Planin e Veprimit Komunal për MSA-në për periudhën janar – dhjetor 2015” raporte të cilat janë dërguar në MIE. Janë identifikuar sfidat nga Raporti i Vendit 2015 për komunat dhe MAPL-në. Është përgatitur “Analiza për përmbushjen e obligimeve të komunave nga agjenda evropiane për periudhën janar – qershor 2015”, si dhe “ Draft Analiza për përmbushjen e obligimeve të komunave nga agjenda evropiane për periudhën korrik – dhjetor 2015” në mënyrë specifike nga Plani i Veprimit Komunal për MSA-në 2015, përmes së cilës janë nxjerrë konkluzionet dhe rekomandimet lidhur me nivelin e përmbushjes së obligimeve nga agjenda evropiane. Janë ofruar informata dhe të dhëna për punën e MAPL-së dhe Komunave për sa i përket raportimit për Inputin e II-të të Raportit të Komisionit Evropian për vendin-Kosovë për periudhën 1 maj 2015–31 gusht 2015, të cilat janë dërguar në MIE. Gjithashtu, janë mbajtur mbi 15 takime me MIE-në dhe Ministrinë e linjës për sa i përket obligimeve që dalin nga procesi i integritimit evropian të Kosovës, si dhe mbi 6 takime të rregullta me zyrtarët komunal për integritime evropiane dhe OJQ-të lokale.

Është bërë verifikimi i listës së aplikimeve të Mbrojtjes Civile për 4 komunat e veriut + qendra 112, si dhe hartimi i Raportit Përmbledhës.

Është hartuar raporti i komunave dhe MAPL-së për obligimet që dalin nga Plani i Veprimit për Liberalizimin e Vizave. Janë bërë përgatitjet për vizitën e ekipit fakt mbledhës të BE-së dhe është aranzhuar vizita e tyre në Komunën e Vushtrisë. Me qëllim të përfitimit nga fondet e IPA-s për Kosovën, janë adresuar projekt propozimet për investime publike në komuna.

Është përgatitur “Udhëzuesi për mënyrën e përfitimit nga Fondet IPA II”, si dhe “Buletini të aktiviteteve ndërmjet MAPL-së dhe Komunave në fushën e IE-së”

Në bashkëpunim me OSBE-në, Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë për Kulturë, Rini dhe Sport, është organizuar trajnimi për studentët praktikant, të cilët janë përzgjedhur si përfitues nga konkursi publik me qëllim të pjesëmarrjes në projektin “Fuqizimi i përfshirjes së rinisë dhe pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje”. Nga ky proces janë përzgjedhur 9 praktikantë, të cilët janë sistemuar në departamentet e MAPL-së për të vijuar punën praktike

Në fushën e ngritjes së kapaciteteve, MAPL në bashkëpunim me IKAP, ka përgatitur programin e trajnimit për zyrtarët komunal për integritime evropiane me temë “ Bashkimi Evropian dhe Procesi i Integritimit”, në bashkëpunim më GIZ ka organizuar

punëtorinë 2 ditore për ZKIE-të dhe Ministrinë e linjës, me temë “Sfidat dhe të arriturat e komunave në përmbushjen e obligimeve që dalin nga agjenda evropiane”, ka mbajtur trajnimin 1 ditor për zyrtarët komunal për integritime evropiane me temë “ Vlerat e bazuara në leadership/udhëheqësi”, trajnim 1 ditor të organizuar nga MAPL në bashkëpunim me USAID me temë “ Obligimet e komunave nga agjenda evropiane”, si dhe trajnimin 1 ditor për zyrtarët e lartë të MAPL-së të organizuar nga Komisioni Evropian (në Bruksel) përmes programit TAIEX lidhur me “Smart Specialisation on Regional Development”. Po ashtu, është hartuar dhe zbatuar programi i trajnimeve në fushën e integritimeve evropiane për zyrtarët komunal për integritime evropiane, zyrtarët e tjerë komunal, zyrtarët e MAPL-së dhe të Ministrive të linjës, me qëllim që këto grupe të synuara të përfitojnë njohuri shtesë për pozitën e tyre që ushtrojnë në komunë, aftësi për të koordinuar të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me procesin e integritimit evropian në nivelin lokal, si dhe të përmirësojnë aspektin e cilësisë së raportimit dhe informatave të cilat dërgohen në MAPL. Ky program është realizuar në bashkëpunim me UNDP. . Në bashkëpunim me Slovenia Development Cooperation MAPL ka përzgjedhur 12 komuna përfituese dhe 2 ministri të linjës për të qenë pjesë e punëtorisë 2 ditore me fokus “Infrastruktura Lokale” e cila është mbajtur në fillim të muajit dhjetor.

Në këtë periudhë, ka vazhduar angazhimi i MAPL-së dhe pjesëmarrja në një sërë takimesh me qëllim të ofrimit të kontributit në rekrutimin e shërbyesve civil për komunat e veriut, debatin për procesin e integritimeve evropiane të organizuar nga Kuvendi i të Rinjve të Kosovës me zyrtarë të partive politike të Kosovës dhe zyrtarë nga Ministrinë e linjës, në strukturat operative dhe komitetet e vlerësimit për bashkëpunimin ndër-kufitar/Ri-thirrja e propozimit të I-rë për programin e IPA – CBC ndërmjet Malit të Zi dhe Kosovës, finalizimin e Planit Kombëtar për Adoptim të Acquis së BE-së, ofrimi i mbështetjes në hartimin e Programit Kombëtar për zbatimin e MSA-së, si dhe finalizimin e Dokumentit Planifikues Konkurrueshmëria, prej të cilit dokument është përgatitur Action Document “Improvement of business services and infrastructure in municipalities”. Kurse, sa i përket adresimit të nevojave të komunave për mbështetje me asistencë teknike nga fondet e BE-së, MAPL ka përgatitur 3 projekt-propozime për programin TAIEX:

- “Zhvillimi i Planeve Lokale për Menaxhimin e Mbeturinave”;
- “Vizitë studimore – Standardet për Menaxhimin e Mbeturinave”.
- “Zbatimi i paketës ligjore për të drejtat e njeriut në nivelin lokal”.

Gjithashtu, MAPL ka dorëzuar aplikacionin për “Çmimin për sektorin publik”, konkurs i hapur nga ESPA.

5. Ngritja e kapaciteteve institucionale të komunave

MAPL ka finalizuar grumbullimin dhe sistematizimin e pyetësorëve për ngritjen e kapaciteteve në komuna për vitin 2015. Është hartuar Raporti për vlerësimin e kapaciteteve në komuna për vitin 2015 dhe Plani i trajnimeve për vitin 2016. MAPL ka vazhduar me plotësimin e databazës dhe menaxhimin e të dhënave të për trajnimet e mbajtura me zyrtarë të komunave nga IKAP dhe partnerët.

Gjatë kësaj periudhe kanë vazhduar përgatitjet teknike dhe organizative për mbajtjen e takimit të dytë me radhë me partnerët për çështjen e ngritjes së kapaciteteve në komuna, ku përfshihen përgatitjet e ftesës dhe agjendës, përgatitjet e drafteve të prezantimeve dhe raporteve që kanë të bëjnë me zhvillimet brenda këtij afati për çështjen e ngritjes së kapaciteteve në komuna. Njëherazi, me qëllim të koordinimit të veprimeve, janë zhvilluar takime me përfaqësues të organizatave ndërkombëtare që e ndihmojnë procesin e ngritjes së kapaciteteve në komuna. Njëkohësisht janë bërë parapërgatitjet teknike për mbajtjen e një punëtorie me temën “Planet e komunave për menaxhimin e mbeturinave” që do të financohet nga TAIEK.

MAPL ka ofruar mbështetjen për trajnimin e 1621 zyrtarëve të komunave në bashkëpunim me partnerët që kanë sponsoruar ofranizimin e trajnimeve. Janë trajnimet për koordinatorët komunal të performancës komunale, si dhe trajnimi me zyrtarë të MAPL-së dhe zyrtarë të komunave për informimin e tyre lidhur për të drejtat e komunitetit LGBT. Janë mbajtur trajnime për zyrtarët e informimit të komunave me temën “Avancimi i transparencës në komuna”.

Me qëllim të forcimit të kapaciteteve institucionale dhe infrastrukturore të komunave, janë lidhur 76 Marrëveshje të Mirëkuptimit në vlerë prej 3,187,445,00 € në mes MAPL dhe Komunave për implementimin e 76 projekteve. Në periudhën raportuese kanë përfunduar 65 projekte. Kurse nga infrastruktura komunale të financuara nga BE për fazën e VII kanë përfunduar 9 nga 20 projekte, është nënshkruar kontrata për finalizimin e 4 objekteve komunale në komunat Obiliq, Fushe Kosove, Podujeve dhe Vushtrri.

Gjatë kësaj periudhe është nënshkruar kontrata për vazhdimin e punimeve në shkollat e komunave të Kosovës të cilat kanë mbet pa u përfunduar në vitin e kaluar. Janë gjithsej

17 shkolla dhe 2 klinika të cilat priten të përfundojnë sipas planit dinamik të kontraktuar. Ky është projekt i BE për efikasitet të energjisë në shkollat e Kosovës. Kanë përfunduar objektet e infrastrukturës komunale në komunat e Kosovës të financuara nga BE për fazën e VII (gjithsej deri tani kanë përfunduar 4 objekte).

6. Performanca Komunale

Gjatë periudhës raportuese, MAPL është fokusuar edhe në fushën e zhvillimit të kapaciteteve dhe performancës komunale. Është punuar në hartimin e raportit vjetor të performancës së komunave (**azhuriteti i administratës komunale dhe cilësia e shërbimeve publike komunale**). MAPL ka mbledhë të dhënat e raportuara nga të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, me përjashtim të komunës së Leposaviqit. Është bërë hartimi i raportit analitik 2010 – 2014 i sistemit të menaxhimit të performancës komunale. Është bërë avancimi i programit elektronik për sistemin e menaxhimit të performancës së shërbimeve komunale (CSC / CSM). Kjo detyrë është në proces të zhvillimit dhe përfundon në vitin 2016. Ka vazhduar me zhvillimin e fushave dhe të treguesve për matjen e performancës së komunave. Është realizuar Mozaiku 2015 – anketimi i qytetarëve për nivelin e kënaqshmërisë së ofrimit të shërbimeve dhe janë bërë përgatitjet për zbatimin e anketës për matjen e kënaqshmërisë së qytetarëve lidhur me ofrimin e shërbimeve komunale. MAPL në bashkëpunim me projektin DEMOS ka arritur që të sigurojë një fond shumë solid për shpërblimin e 17 komunave partnere të DEMOS.

Është bërë analiza e funksionimit të Sistemit për Menaxhim të Performancës së Komunave, është bërë vlerësimi i treguesëve të SMP dhe është vlerësuar nevoja për rishikimin e treguesve të SMP-së.

7. Promovimi i të drejtave të njeriut në Komuna

MAPL/DADNJK, konform planit të punës, me qëllim të përmbushjes së obligimeve që dalin nga strategjitë kombëtare, ka marrë pjesë vazhdimisht në grupet e ndryshme punuese, ku qenë pjesë e *Grupit Teknik të Punës për Koordinimin e Zbatimit të Rekomandimeve të Konventës Kornize për mbrojtjen e Pakicave Kombëtare*. MAPL ka përgatitur për Këshillin e Evropës, rekomandimet lidhur me zbatimin e Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare. Është hartuar raporti me të dhënat e grumbulluara nga pyetësorët të cilët janë shpërndarë komunave, lidhur me promovimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut në nivel lokal. Gjatë periudhës në fjalë (Janar-Dhjetor, 2015) MAPL ka plotësuar rregullisht draft-dokumentin për DPSA “Kriteret Politike - Të Drejtat Themelore dhe Kapitulli 23 Standardet Evropiane”, në fushën e të drejtave të njeriut dhe të drejtat pronësore, si dhe raportimi në Qeverinë e Republikës së Kosovës lidhur me zbatimin e Planit të Punës së MAPL-së për periudhën K2 të vitit 2015

(Prill-Qershor). Gjithashtu është përgatitur drafti me rekomandime shtesë për Planin e Veprimit për zbatimin e Pakos së Ligjeve për të Drejtat e Njeriut, si:

- Plotësimi i raportit të komunave, për gjashtë mujorin e parë të vitit 2015;
- Përgatitja e komenteve për draft ligjin për të drejtat e fëmijëve.

Është realizuar fushata për regjistrimin falas të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Gjatë fushatës janë identifikuar 233 persona të pa regjistruar dhe se 90 prej tyre kanë arritur të regjistrohen gjatë fushatës.

Është organizuar fushatë vetëdijësuese në komuna për të drejtat e barabarta në trashëgimin pronësore për të dy bashkëshortët.

MAPL gjatë kësaj periudhe ka qenë pjesëmarrëse aktivitetet e tjera, si vijon:

- Vetëdijësimin e mbi rëndësinë e të drejtave gjuhësore, për të identifikuar pengesat e përputhshmërisë së plotë me legjislacionin mbi gjuhët dhe gjetja e mekanizmave për t'i kapërcyer këto pengesa;
- Pjesëmarrja në punëtorinë e organizuar nga Zyra e Komisionarit për gjuhët në Republikën e Kosovës dhe OSBE;
- Pjesëmarrja në takimin e radhës në Komisionin Qeveritar për Persona të Zhdukur;
- Pjesëmarrje në takimin e rregullt të Këshillit për Zbatimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2013-2017, i cili është organizuar nga Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit;
- Takim me udhëheqësit e departamenteve lidhur me rishikimin e draftit të parë të raportit të KE-së për vendin-Kosovë për vitin 2015 për periudhën 1 maj - 31 gusht 2015;
- Takimi me ZQM/ZKM për përgatitjet e punëtorisë për strategjinë e re për komunitetet RAE;
- Janë mbajtur pesë (5) takime regionale me qëllim të informimit të zyrtarëve komunal rreth fushatës senzibilizuese për të drejtat e komuniteteve dhe pakon ligjore për të drejtat e njeriut
- Pjesëmarrja në takimin e organizuar nga koordinatori nacional, zv. Ministri i ministrisë së drejtësisë, për fillimin e hartimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Dhunës në Familje 2016-2021;
- Është organizuar Fushata Kundër dhunës në familje.

- Janë dhënë komentet në Koncept-dokumentin për hartimin e Projektligjit për ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-019 për Punësimin, Aftësimin dhe Ripunësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Është dhënë kontributi për hartimin e Udhëzimit Administrativë për regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve
- Janë mbajtur takime koordinuese me zyrtarët ndërministror për barazi gjinore të MD dhe MMPH;
- Pjesëmarrje në punëtorinë e organizuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me temën: “Administrimi i Ndërtesave në Bashkëpronësi;
- Pjesëmarrja në komisionin për shqyrtimin e dy ankesave të zyrtarëve të MAPL-së lidhur me kundërshtimin e vendimit për përvojën e punës.
- Janë përgatitur rekomandimet për Planin e Veprimit për zbatimin e Pakos së Ligjeve për të Drejtat e Njeriut;
- Janë monitoruar 11 komuna lidhur me funksionimin e NJDNJK-ve dhe për zbatimin e Strategjive dhe Planeve të Veprimit për të drejtat e Njeriut.
- Është nënshkruar Marrëveshja mes MAPL-së dhe GIZ për realizimin e projektit dy vjeçar SoRi ku do të përfshihen komunat (Prishtinë, Prizren, Gjilan, Ferizaj dhe Glllogoc/Drenas). Projekti është i nivelit rajonal dhe janë të përfshira: Kosova, Shqipëria, Serbia, Maqedonia, dhe Bosnja e Hercegovina. Qëllimi i projektit është përmirësimi i ofrimeve të shërbimeve të drejtave sociale në nivelin lokal, si: edukimi, informimi i qytetareve në qasjen e shërbimeve sociale, ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve, ofrimi i shërbimeve nga OJQ-të etj.

Janë hartuar raportet si vijon:

1. Raporti për monitorimin e NJDNJK;
2. Raporti për bashkëpunim me shoqërinë civile;
3. Raporti për promovimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut në komuna;
4. Plotësimi i raportit të komunave, për gjashtë mujorin e parë të vitit 2015;
5. Përgatitja e komenteve për draft ligjin për të drejtat e fëmijëve;
6. Raportet e rregullta për Qeverinë e Republikës së Kosovës
7. Raporti i përgatitur për Këshillin Evropës - GRETA
8. Raporti për MPB - Grupi Ndërministrorë për Kundër trafikim me qenie njerëzore
9. Raporti për Departamentin e Shtetit Amerikan, Kundër -trafikim me qenie njerëzore
10. Raporti për grupin parlamentar për integritet evropian;
11. Përgatitja e komenteve për draft ligjin për të drejtat e fëmijëve; Pakon ligjore për të drejtat e njeriut si Ligjin për Barazi Gjinore, Ligjin për Avokatin e Popullit dhe Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi.

8. Promovimi i transparencës

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2015, MAPL ka hartuar raportin krahasues për kërkesat për qasje në dokumente publike në Komuna 2014-2015. Është bërë inkorporimi i propozimeve të komunave për plotësimin dhe ndryshimin e Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna. Është hartuar shkresa rekomanduese dhe Model-Plani i veprimit për Transparencë në Komuna, si dhe është dorëzuar në të gjitha komunat me qëllim të lehtësimit të komunave në përmbushjen e obligimeve ligjore.

Është bërë monitorimi i vazhdueshëm i faqeve zyrtare elektronike të komunave. Mbi bazën e këtij procesi janë hartuar raportet tre-mujore për zbatimin e transparencës në komuna si dhe raporti për publikimin e buxhetit në faqet zyrtare elektronike të komunave për gjashtë mujorin e parë të vitit 2015. Gjatë kësaj periudhe MAPL ka hartuar raportin për qasjen në dokumentet publike të publikuara në ueb-faqet e komunave. Janë dhënë informatat për zyrën e kryeministrit lidhur me qasjen në dokumentet publike në komuna. Po ashtu është hartuar Doracak i për transparencë në komuna.

Në bashkëpunim me OSBE-në dhe KDI-në janë organizuar 3 punëtori për identifikimin e indikatorëve të transparencës. Është hartuar drafti fillestar i indikatorëve për transparencë në komuna. Në vazhdimësi janë monitoruar ueb-faqet zyrtare të komunave. Gjatë kësaj periudhe zyrtarët e MAPL-së kanë marrë pjesë në takimin e komisionit për Rishikimin e dokumenteve strategjike, ligjore dhe nënligjore me qëllim të evidentimit të barrierave që kufizojnë konkurrencën e lirë punues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe në grupin punues të Zyra e Komisionerit për gjuhët lidhur me hartimin e Strategjisë për zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve.

Për një komunikim më efikas me ministrinë e linjës, komunat, shoqërinë civile, mediet, por edhe me partnerët tjerë të rëndësishëm, bazuar në prioritetet e Qeverisë dhe planin e punës së MAPL-së, aktivitetet e MAPL-së janë realizuar në mënyrë transparente dhe të hapur për publikun, nëpërmjet komunikimit me media, zbatimit të ligjit për qasje në dokumente publike dhe publikimit të informatave në ueb-aplikacionin e MAPL-së.

Në kuadër të prezantimit të aktivitet aktivitetëve të Ministrisë janë dërguar në media 3 informata, ndërsa në saje të plotësimit të kërkesave të gazetarëve për marrë informata nga MAPL për çështje të interesimit medial, janë dërguar në media 9 përgjigje për tema me interes për publikun. Të gjitha aktivitetet e Ministrisë anë prezantuar në ueb-faqen zyrtare.

Në sajë të zbatimit të Ligjit për Qasja në Dokumente Publike, përkitazi me kërkesat e pranuar, MAPL ka ofruar qasje në Dokumente Publike në tri informata (dy kërkesa nga mediat, një kërkesë nga shoqëria civile).

9. Administrata dhe Financat

Më qëllim të plotësimit të obligimeve ligjore si dhe realizimin e punëve, aktualisht në MAPL janë të punësuar gjithsej 116 shërbyes civil. Sipas përkatësisë gjinore janë 63 meshkuj dhe 53 femra, kurse sipas përkatësisë etnike janë 10 serb, 2 turq dhe të tjerët shqiptarë, duke respektuar kështu të drejtat e veçanta të komuniteteve për përfaqësim në administratë publike.

Për vitin 2015, MAPL ka pasur në dispozicion një shumë prej 4,476,054.95 € të ndara nga buxheti shtetit. Sa u përket shpenzimeve, në vitin 2015 të këtij viti, buxheti është shpenzuar në shumën prej 3,825,642.16 €.